

KOMUNIKATË PËR MEDIA


Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP), TM1 2025

28.05.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e parë (TM1) 2025, viti bazë 2010=100.

Çmimet e importit më të ulta në TM1 2025 sesa në TM1 2024

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë është i njëjtë me 0,1% në TM1 2025, krahasuar me TM4 2024. Në TM1 2024, çmimet e importit patën një rënie në një mesatare prej (-1,9%).



Tremujori i parë 2025 / Tremujori i katërt 2024 0,1 %

Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: shtazët e gjalla, produktet e shtazëve (6,8%); produktet bimore (2,7%); lëkura dhe artikujt e saj (1,6%); produktet minerale (0,7%); artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (0,6%); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (0,3%); dhe plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (0,2%).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit te: artikujt e ndryshëm të prodhuar (-4,1%); vajrat ushqyese (-3,1%); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-2,2%); instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinal, muzikore dhe mekanizmat e orës (-1,4%); mjetet e transportit (-0,4%); produktet e industrive kimike (-0,3%); letra dhe artikujt e saj (-0,2%); druri dhe artikujt e tij (-0,1%); dhe artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (-0,1%).

Tremujori i parë 2025 - Tremujori i parë 2024 -1,9%

Çmimet e Importit në Kosovë patën një rënie në një mesatare prej (-1,9%) ndërmjet TM1 2025 dhe TM1 2024. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: produktet bimore (4,2%); shtazët e gjalla dhe produktet e shtazëve (1,2%); tekstili dhe artikujt e tekstit (1,1%); druri dhe artikujt e tij (0,9%), etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve: lëkura dhe artikujt e saj (-23,6%); artikujt e ndryshëm të prodhuar (-8,4%); produktet minerale (-8,1%); instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale dhe muzikore dhe mekanizmat e orës (-6,6%); vajrat ushqyese (-6,2%), etj.

Ndryshimet tremujore dhe vjetore në % sipas sektorëve

Kodi	Grupi	Pesha	TM1- 2025	TM1 - 2025	TM1 - 2025
			2010 =100	TM4-2024	TM1 - 2024
01-21	IÇIMP - Gjithsej	1000	162.8	0.1	-1.9
01	Shtazët e gjalla; produktet e shtazëve	38	186.1	6.8	1.2
02	Produktet bimore	50	385.3	2.7	4.2
03	Vajrat ushqyese	10	205.7	-3.1	-6.2
04	Artikuj ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani	131	136.8	-0.1	-0.1
05	Produktet minerale	147	213.4	0.7	-8.1
06	Produktet e industrive kimike	80	126.7	-0.3	-1.0
07	Plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre	64	152.9	0.2	-2.3
08	Lëkura dhe artikujt e saj	2	90.3	1.6	-23.6
09	Druri dhe artikujt e tij	26	182.9	-0.1	0.9
10	Letrat dhe artikujt e saj	16	134.8	-0.2	0.1
11	Tekstili dhe artikujt e tekstit	44	102.8	0.0	1.1
12	Këpucët	12	155.8	0.0	0.3
13	Artikujt e gurit, të llaçit, produktet e keramikës dhe te qelqit	34	193.7	0.6	-0.1
14	Margaritarët, gurët e çmuar, metalet, etj.	:	:	:	:
15	Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	100	162.1	-2.2	-3.8
16	Paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike	118	123.6	0.3	0.1
17	Mjetet e transportit	88	151.8	-0.4	-0.1
18	Instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës	10	118.9	-1.4	-6.6
19	Armët dhe municioni	:	:	:	:
20	Artikujt e ndryshëm të prodhuar	28	121.4	-4.1	-8.4
21	Veprat e artit	:	:	:	:

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e parë TM1- 2025, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation>